



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

**Fakulteti:** Bujqësisë dhe Veterinarisë

**Departamenti:** AGROEKONOMI

**Programi:** EKONOMIA E BUJQËSISË DHE USHQIMIT

**NJOFTIM**

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se:

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidatja DAFINA MEHMETI, me titull: **“Analiza kost-benefit e kultivimit të kamomilit në Kosovë”** ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 15.01.2024 deri me datë 23.01.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Joachim AURBACHER kryetar,
2. Prof. Jehona SHKODRA, mentor - anëtar,
3. Prof. Arben MEHMETI, anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Asoc. Dr. Jehona Shkodra, përmes e-mail adresës [jehona.shkodra@uni-pr.edu](mailto:jehona.shkodra@uni-pr.edu)

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë!

## ABSTRAKT

Kamomili (*Matricaria chamomilla*) si një bimë mjekësore dhe aromatike ka rëndësinë e vet në aspektin ekonomik dhe është një produkt i vlefshëm në tregun botëror të bimëve mjekësore dhe aromatike. Megjithatë, deri më tani nuk ka pasur asnjë hulumtim në lidhje me analizën e kostos dhe përfitimit të kultivimit të kamomilit në Kosovë.

Ky studim synon të kryejë një analizë kosto-benefit të kultivimit të kamomilit (*Matricaria chamomilla*) në Kosovë, me objektivat specifike duke përfshirë krahasimin e rentabilitetit midis madhësive të ndryshme të fermave, vlerësimin e opinionit subjektiv të fermerëve mbi fitimin, identifikimin e sfidave kryesore në kultivimin e kamomilit, dhe ofrimin e rekomandimeve bazuar në gjetjet.

Është përdorur një qasje e kombinuar duke përfshirë hulumtim bazuar në zyrë dhe punën në fushë, duke përfshirë intervista me 17 fermerë të kamomilit. Të dhënat, si ato sasiore dhe cilësore u morën dhe u analizuan përmes SPSS (Paketa Statistiko-Shoqërore për Shkencat Shoqërore).

Studimi tregon gjetjet sa i përket dispariteteve gjinore në mesin e fermerëve të kamomilit, ku shumica e tyre ishin meshkuj. Pjesa substanciale e fermerëve është nën moshën 30 vjeç, ky është një tregues i mirë i angazhimit të brezit të ri. Ka një shpërndarje jo uniforme gjeografike të fermave të kamomilit në Kosovë, rajoni i Pejës dhe Prishtinës kanë koncentrimin më të lartë. Shumica e fermerëve kanë shkollim universitar ose nivel master. Shumica operojnë në fusha më të vogla dhe me qera. Analiza e korrelacionit sugjeron lidhje të dobëta midis faktorëve të ndryshëm, të ardhurave dhe kostove. Fermat më të mëdha kanë tendencë të arrijnë një rentabilitet pak më të lartë në krahasim me fermat më të vogla. Ekzistojnë opinione të ndryshme midis fermerëve lidhur me qëndrueshmërinë ekonomike të kultivimit të kamomilit. Kultura alternative janë konsideruar menta (*Mentha spicata*), hithra (*Urtica dioica*) dhe gruri (*Triticum aestivum*). Gjetjet e studimit japin informacione për strategji të promovimit të barazisë gjinore, arsimit, qasjes në tokë, menaxhimit financiar dhe diversifikimit të kulturave në sektorin e kultivimit të kamomilit në Kosovë.

**Fjalë kyçe:** Kultivimi i kamomilit, Analiza kosto-benefit, Menaxhimi i fermës, Disparitetet gjinore, Diversifikimi i kulturave, Bujqësia në Kosovë.